



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ROZETA A. KUKA
ADRESA NR.9, HAXHI DALLIU
TEL: 682080653

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 2052

Nr. koleksioni: 796

Tirane më 15/11/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024052810075445326



A202405281007545326

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE ROZETA A. KUKA

ADRESA: Rr. "Haxhi Dalliu". Përballë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë;

Taksa e pullës u pagua

AKT - THEMELIMI
i
SHOQËRISË "TRUSTMARK CERTIFIERS" SHPK

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"TRUSTMARK CERTIFIERS"

Në këtë statut:

- "Ligji" është ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
- "Statuti" është ky statut i shoqërisë;
- "Shoqëria" është shoqëria "Trustmark Certifiers" sh.p.k, për rregullimin e së cilës hartohet ky statut;
- "QKB" është Qendra Kombëtare e Biznesit e cila është themeluar dhe vepron në bazë të ligjit Nr. Ligji 131/2015 datë 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit" i ndryshuar.

Titulli I

Neni 1:

Themelimi, emertimi, objekti, kohezgjatja, selia.

Sot, më 15.11.2024 (dymijë e njëzetë e katër), ditën e premte, në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. Ligji 131/2015 datë 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit".

Ortaku themelues:

-**Z. Ermir Çupi**, atësia Aqif, amësia Vera, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel, Mat dhe banues në Tiranë, me adresë Dalë Ndreu; Nd. 43; H. 9; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 09/05/1975, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035763721 dhe nr. personal H50509142K;

I cili vijnë në cilësinë e themeluesit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Trustmark Certifiers" shpk;

Themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Trustmark Certifiers" sh.p.k.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria "Trustmark Certifiers" sh.p.k, ka për objekt; **Kontrolli i prodhimit në fabrikë.**

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë "Trustmark Certifiers" sh.p.k, është e pakufizuar në kohë. Aktiviteti i tij përfundon nëse është arritur qëllimi i tij ose ky i fundit bëhet i përealizueshëm, por gjithmonë në përputhje me ligjet shqiptare dhe me këtë statut. Personaliteti juridik i shoqërisë mbaron në ditën kur shoqëria ç'regjistrohet në QKB.



A2024052810075445326

Neni 4:**Selia**

4.1 Shoqëria "Trustmark Certifiers" sh.p.k do të ushtrojë aktivitetin e tij në të gjithë territorin e Shqipërisë. Selia e saj është në Tiranë, në adresën: **Rruga Janos Hunyadi (ish Vaso Pasha), Pallati Nr. 26, Hyrja Nr. 1, Apartamenti Nr. 1.**

4.2 Shoqëria "Trustmark Certifiers" sh.p.k duke patur parasysh nevojat e saj mund të hapë zyra përfaqësimi dhe/ose degë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto degë nuk janë persona juridikë të veçantë por pjesë të shoqërisë. Gjithashtu, mund të krijohen degë ose filiale të shoqërisë, jashtë territorit të Shqipërisë.

Titulli II**Kapitali****Neni 5:****Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali fillestar i shoqërisë "Trustmark Certifiers" sh.p.k është **10 000 (dhjetë mijë) lekë të reja**, i përbërë nga 1 (një) kuota. Pjesëmarrja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

--**Z. Ermir Çupi**, zotëron një kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit, me vlerë 10 000 (dhjetë mijë) lekë të reja;

Neni 6:**Kuotat, të drejtat dhe kufizimet**

6.1 Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar (me tri të katërtat e votës) të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Nenin 87, gjithsesi e kushtëzuar nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 7:**Certifikatat e kuotave të kapitalit**

7.1 Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72 paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në certifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

Neni 8:**Kalimi i kuotave me kontratë**

8.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe vetëm me akt noterial dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet shoqërisë. Pjesë të kapitalit themeltar mund t'i transferohen edhe personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të kualifikuar të ortakëve të shoqërisë (me 3/4) pasi të jetë ezauruar ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ortakët ekzistues dhe nëse është dhënë aprovimi respektiv nga autoriteti kontraktor i kontratës së koncensionit.

Titulli III**Asambleja e Përgjithshme****Neni 9:****Të drejtat dhe detyrimet**

9.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;



A2024052810075445326

- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10:

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 1) Administratori mund të thërrasë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kur ta mendojnë të arsyeshme vetë dhe sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit dhe sa herë. Mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën 1 herë në vit sipas Nenit 82 të Ligjit.
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i cili duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e Mbledhjes si edhe Rendin e ditës, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.
- (3) Mosveprimi i paqëllimtë për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit për mbledhjen nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 11:

Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 11.1 Punimet e mbledhjes së asamblese së përgjithshme nuk fillojnë nëse nuk plotësohet kuorumi i parashikuar nga neni 86 i Ligjit.
- 11.2 Në rast se nuk arrihet kuorumi i kërkuar sipas paragrafit të mësipërm në mbledhjen e parë, mbledhja e Asamblesë së ortakëve shtyhet për një ditë tjetër brenda, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditëve konsektive.
- 11.3 Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.4 Të pranishmit në Mbledhje caktojnë si Kryetar anëtarin më të vjetër në moshë për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes, i cili përbën evidentimin *prima facie* të procedimit të mbledhjes, duhet të nënshkruhet nga kryetari i saj dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 11.5 Nëse Kryetari i Mbledhjes nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, dhe asnjë anëtar tjetër i Asamblesë nuk pranon të jetë Kryetari i mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.
- Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.6 Me pëlqimin e pjesëmarrësve në mbledhje, në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhjen e shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e



A2024052810075445326

Asamblesë janë shtyrë për katërpëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të rendit të ditës që do të diskutohet.

Vendimet që duhen miratuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë;

1. Kryetari; ose

2. Një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se 20% të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

Neni 12:

Votat e ortakëve

(1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.

(3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Titulli IV

Administratorët

Neni 13:

Emërimi i administratorit

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator/ë të shoqërisë për një afat të caktuar (jo më shumë se 5 vjet) me të drejtë rizgjedhjeje sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimi i nënshtrohet individualisht një vendimi të zakonshëm i cili, nëse miratohet, passjell zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.

Administratori i shoqërisë do jetë Z. Ermir Çupi, atësia Aqif, amësia Vera, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel, Mat dhe banues në Tiranë, me adresë Dali Ndreu; Nd. 43; H. 9; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 09/05/1975, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035763721 dhe nr. personal H50509142K;

Neni 14:

Kompetencat e Administratorëve

(1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë administrohet nga Administratorët të cilët mund t'i ushtrojnë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit. Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorëve të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishte dhënë direktiva.

(2) Veprimtaria e administratorëve duhet të udhëhiqet dhe t'i përmbahet politikave tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

(3) Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre komiteteve që përbëhen nga një ose më shumë Administratorë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vendosin



A2024052810075445326

Administratorët dhe mund të revokohen ose të ndryshohen. Administratorët nuk mund të delegojnë asnjërin prej detyrimeve të cilat ua ngarkon ligji.

(4) Administratorët/i, përveç sa parashikon legjislacioni në fuqi, kanë edhe këto të drejta dhe detyrime:

-Të kryejnë të gjitha operacionet financiare dhe/ose tregtare (kontrata të Leasing, operacione te cedimit të kredise) aktive dhe pasive në lidhje me operacionet që janë të përfshira në objektin e shoqërisë duke marrë angazhimet dhe kryerjen e formaliteteve të nevojshme, duke përfshirë dënimin e dorezanive, gjithçka në kufijte e sa është parashikuar me sipër ;

Marrjen dhe dënimin e tendereve për kryerjen e punimeve dhe administrimit të çfaredolloji duke lidhur kontratat përkatëse, duke marrë pjesë në gara tenderesh nëse është rast, në ankande publike dhe private, duke emëruar sipas rastit përfaqësues të posaçëm për të marrë pjesë në tenderet përkatës, ankande deri në pagesën e shumës;

-Të sigurojë për llogari, në emër dhe në interes të shoqërisë në marrjen dhe tërheqjen e të gjitha shumave dhe vlerave që i detyrohen shoqërisë për çfaredo shkak nga çfaredo person, si edhe nga administratat e Shtetit dhe nga organet e pushtetit lokal dhe në përmbartimin e mandateve që janë emëruar ose që do të emëtohen në të ardhmen, pa kufizime kohore, në favor të shoqërisë për çfaredo shumë të kapitalit ose interesa që i detyrohen asaj nga administratat e sipërpermendura dhe nga zyrtarët dhe institutet e mesiperme, si në likuidim të depozitave të bera nga vete shoqëria, ashtu edhe për çfaredo shkak ose titull, të leshojë në emër të shoqërisë deklaratat përkatëse të faturave dhe të shkarkimit dhe në përgjithësi të gjitha deklaratat që mund të kërkojnë për përmbushjen e secilës prej praktikave duke përfshirë edhe ato të përjashtimit të zyrtarëve, administratave dhe instituteve të mesiperme nga përgjegjësia në lidhje me to ;

-Të blejë, shesë ose shkëmbejë makina, mallra, lëndë të para dhe sende të luajtshme dhe automjete të regjistruara, të japë dhe marrë komisione, të nënshkruajë letra, dëftesa, fatura, të xhirojë për arkëtim çeqe, kambiale dhe tituj të tjerë kredie ;

-Të përfaqësojë shoqërinë, në mënyrë aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjyqimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse pra edhe me lëshimin e prokurave, mandateve të veçantë për avokatë, mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarrëveshje;

-Të lëshojë ose të revokojë mandate ad lites avokatëve dhe mbrojtësve dhe ad negotia punonjësve të shoqërisë ose të tretëve për një ose më shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;

-Të paguajë kambiale, xhiroje, paguaja dhe njohe çeqe bankare, kambiale dhe cdo lloj titulli kredie, dergesa të hollash me poste të pagueshme në përgjithësi pranë cdo personi fizik ose juridik ;

-Të çelë llogari rrjedhëse bankare, të kryejë tërheqje parash, të japë dispozita të pagesës, të firmosë çeqe që të kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, edhe të zbuluar, në kufijte të besueshmërisë së atij momenti (overcover), të verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe të miratojë llogarinë;

-Të punësojë, të pezullojë, të pushojë nga puna dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;

-Të ndërveprojë me Entet e Administratës Publike për çdo negociim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;

-Të marrë masa për llogari, në llogari, në emër dhe në interes të shoqërisë për krijimin e Shoqërive të Përkohshme të Sipërmarrjeve, në cilësinë e shoqërisë të përfaqësuar ose përfaqësuese, për projekte që janë të përfshirë në objektin e shoqërisë;

-Të lëshojë ekstrakte të borderove dhe vërtetime që lidhen me personelin, si për entet e sigurimeve shoqërorore, ashtu dhe për ente të tjera ose private; të kujdeset për respektimin e përmbushjeve ndaj të cilave shoqëria është e detyruar me të drejtën për të nënshkruar deklaratat tatimore që kanë lidhje me mbajtjet nga të ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;

-Të nënshkruajë deklaratat fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësime nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shalle, me të drejtën për të emëruar mbrojtës të posaçëm;



A2024052810075445326

- Të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim sigurimin e licencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe përfaqësues të posaçëm;
- Të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhëse dhe ekstarakte periodike të llogarive rrjedhëse për vartësit e shoqërisë për shumat e depozituara pranë saj;
- Të nënshkruajë kontrata shitblerjeje mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë;
- Të mbajë dhe të nënshkruajë korrespondencën e shoqërisë;
- Të emërojë të përfaqësues të posaçëm për të tërhequr vlera, letra postale, pako, letra rekomande dhe të siguruara pranë zyrave postale dhe telegrafike;
- Të tërheqë vlera, letra postale, pako, letra rekomande dhe të siguruara pranë zyrave postale dhe telegrafike;
- Të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe operacioni pranë zyrave të postës dhe telegrafit;
- Të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe operacioni pranë zyrave pranë zyrave hekurudhore, doganore, të postelegrafit dhe në përgjithsi pranë çdo zyre publike dhe private të transportit, me kompetencën për të leshuar deftesat perkatese të lirit, deklaratat e shkarkimit dhe lejimit të detyrimit dhe lirimit nga detyrimi;
- Të përfaqësojë shoqërinë në zhvillimin e të gjitha praktikave që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë, transmetimin e dokumentave, të dhënave dhe njoftimeve;
- Të ndërtojë, të përfundojë dhe të administrojë marrëdhënie bankare, duke rënë dakort mbi afatet dhe kushtet;
- Të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumenteve të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;
- Të përfaqësojë shoqërinë në asambltetë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emërojë përfaqësues ad negotia;
- T'i japë ekzekutim, në kufijtë e kostos së parashikuar nga planbiznesi dhe nga buxheti i shoqërisë, i miratuar paraprakisht nga Asambleja e Ortakëve, investimeve dhe veprimtarive të parashikuara në to;
- Të delegojë me mandat dhe/ose prokurë sa i takon kompetencave të tij. Perdorimi i firmes dhe përfaqësimi para të tjerëve i perket edhe secilit prej përfaqësuesve të tyre në kufijtë e kompetencave që u janë dhënë vetë administratoreve, si dhe çdo gjë tjetër sic parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

Neni 15:

Shkarkimi dhe largimi i administratorëve

Funksioni i Administratorit lirohet nëse:

- 1.pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë Nenin 95 paragrafi (6).
- 2.vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- 3.jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
- 4.ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Administratorëve të tjerë, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 16:

Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve

- 16.1 Administratorët kanë të drejtë të marrin shpërblim për punën e tyre, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
- 16.2 Administratorëve u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera që u lindin në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e Administratorëve apo të komiteteve të Administratorëve ose në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme apo mbledhje të veçanta të zotëruesve të klasave të aksioneve të shoqërisë, si edhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre.

Titulli V

Dividendët

Neni 17:

Dividendët



A2024052810075445326

17.1-Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

17.2 -Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuota emetohen me kushtin sipas të cilit dividendit mund të merret duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e përfiton dividendin sipas këtij kushti.

17.3 -Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

17.4 -Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë por ta administrojë atë në formën e miratuar në Mbledhjen e Asamblesë me vendim të kualifikuar.

Titulli VI Prishja dhe njoftimet

Neni 18: Prishja dhe likuidimi

18.1 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

Neni 19: Njoftimet

19.1 Njoftimet që u bëhen ortakëve ose që bëjnë personat sipas Statutit duhet të jenë me shkrim ose me letër rekomande me marrje përgjigje në adresën e mëposhtme për ortakun.
- ermircupi@yahoo.com

Unë Noterja verifikova identitetin e palës nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË "TRUSTMARK CERTIFIERS" SH.P.K

Z. Ermir ÇUPI

ERMIR ÇUPI



NOTERE

ROZETA A. KUKA